

Emri i Lëndës : Njohuri rreth Kur'anit dhe përkthimit të tij

Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ISC 113	B	1	2	0	0	2.00	5
Lektori dhe orari i konsultimeve			Elton Karaj, Msc				
Asistenti dhe orari i konsultimeve							
Gjuha e kursit			Albanian, Turkish				
Niveli i lëndës			Bachelor				
Përshkrimi			Lënda "Njohuri rreth Kur'anit dhe përkthimit të tij" është në formën e hyrjes në shkencat e Kur'anit, ndër të cilat në krye vjen historia e këtij libri hyjnor. Këtu do të bëhet fjalë për përkufizimin e gjerë të Kur'anit, formave të shpalljes hyjnore, historisë së tekstit të Kur'anit, që nga shkëputja prej Zotit, e deri tek forma e tij në ditët e sotme. Do të studiohen të gjitha etapat historike dhe shndërrimet fizike që ka pësuar libri përgjatë historisë, si dhe pjesët e tij përbërëse. Duke analizuar edhe një tekst shembull, përftohen njohuri edhe rreth përkthimit të tij, gjë e cila është themelore për çdpkënd, që nuk e ka arabishten gjuhën mëmë, apo që do ta shpjegojë Kur'anin në një gjuhë tjetër veç arabishtes. Kjo lëndë realizon parapërgatitjen e studentit për lëndën e shkencave të Kur'anit. Kështu ai do të jetë formuar me njohuritë hyrëse në këtë fushë dhe do ta ketë shumë më të lehtë drejtëkuptimin e brendisë së tekstit të këtij libri.				
Objektivat			Ka për qëllim që t'i paraqesë studentëve njohuri hyrëse rreth shkencave të Kur'anit, duke i pajisur ata me informacion relativisht të mjaftueshëm në çështjet e zbritjes dhe transmetimit të tekstit kur'anor. Kështu, synohet prezantimi i një portreti të mirëfilltë të Librit Hyjnor.				

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Përkufizimi klasik i Kur'anit Fisnik dhe komentimi i saj i gjerë.
2	Përkufizimi i Kur'anit në traditën profetike dhe komentimi i saj.
3	Vahji, përkufizimi dhe llojet e tij.
4	Etapat e udhëtimit të Kur'anit deri në zbritjen e tij tek Profeti (s.a.s).
5	Ruajtja e Kur'anit në jetën e Profetit (s.a.s).
6	Grumbullimi i Kur'anit gjatë periudhës së kalifit të parë Ebu Bekrit (r.a).
7	Termet ajet dhe sure, dhe veçoritë e tyre.
8	Provim Gjysmëfinal
9	Suret e ajetet mekase dhe ato medinase. Dallimet mes tyre dhe format e emërtimit të sureve.
10	Shumimi i Kur'anit në periudhën e kalifit të tretë Osmanit (r.a).
11	Shtatë shkronjat dhe shkenca e kiraeteve.
12	Historiku dhe zhvillimi i pikëzimit dhe vendosjes së harekeve në tekstin e Kur'anit. Ndalesat gjatë leximit të tekstit.
13	Termet e spikatur në shpjegimin dhe drejtëkuptimin e tekstit hyjnor: Tefsir, te'uil, përkthim dhe meal.
14	Përkthimi i krahasuar i sures Huxhurat - 1.
15	Përkthimi i krahasuar i sures Huxhurat - 2.
16	Provim Final
Parakushtet	

Literatura	• Suat Yıldırım, Anahatlarıyla Kur'an-ı Kerim ve Kur'an İlimlerine Giriş, Ensar Yay, İstanbul, 2009.
Referenca të tjera	• İsmail Cerrahoğlu, Tefsir usûlü, Türkiye Diyanet Vakfı Yayınları, Ankara 1988.
Punë laborator	
Përdorimi i komp.	
Të tjera	

Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat

1	Studentët do të pajisen me njohuri të përgjithshme rreth përkufizimit të Kur'anit nga disa këndvështrime.
2	Studentët do të pajisen me njohuri të detajuara rreth zbritjes dhe transmetimit deri në ditët e sotme të tekstit kur'anor.
3	Studentët do të pajisen me njohuri hyrëse rreth metodave të përkthimit të Kur'anit.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	1	35
Kuize	0	0
Projekte	1	10
Projekte semestrare	0	0
Punë laborator	0	0
Pjesëmarrja në mësim	0	0
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		45
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		55
Total		100

Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	2	32
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	1	0	0
Gjysmë finale	1	21	21
Provimi final	1	30	30
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5
ECTS			5